

## Udhëtarët shqiptarë u rikthehen trageteve



-24 përqind më shumë se në 6 muajt e parë të vitit të kaluar-

Tragetet e linjave nga porti i Durrësit gjatë periudhës janar-qershor të këtij viti kanë transportuar 186.394 udhëtarë shqiptarë.

Sipas statistikave të Autoritetit portual ky numër është 24 përqind më i lartë se sa shifrat e 6-mujorit të parë të vitit 2010. Numri i udhëtarëve në dalje nga Durrësi drejt vendeve të tjera mbetet më i lartë se sa ai i qytetarëve që preferojnë të mbërrijnë me tragete në port.

Tragetet që lundrojnë nga Durrësi në portet e Barit, Ankonës dhe Triestes dhe anasjelltas në periudhën janar-qershor 2011 kanë transportuar 281.350 udhëtarë vendas dhe të huaj gjithsej, ose 23.297 udhëtarë më shumë se në periudhën janar-qershor të vitit paraardhës-shtuan burimet portuale.

Tragetet kanë transportuar gjithashtu rreth 86 mijë autovetura, kamjonë dhe trajlera me 375 mijë ton mallra gjithsej.

